



EDUKIMI MJEDISOR



Tetor 2025

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

“Shiko thellë në natyrë dhe atëherë do të kuptosh gjithçka më mirë”.

Albert Einstein

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujor **Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura** paraqet aktivitetet e zhvilluara nga **12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura**, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatë muajit **tetor 2025**. Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **501**

Specialistë të angazhuar **22**

Orë mjedisore të realizuara **26**

26 Shkolla të përfshira

26 Mësues të përfshirë

“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



17 tetor 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Shkodër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Lucë Agraja” në Dajç, në bashkëpunim me Shoqatën Cukali, brenda zonës së mbrojtur “Lumi Buna – Velipoj. Përmes një prezantimi informues, videove motivuese dhe vizatimeve, nxënësit u njohën me biodiversitetin dhe pasuritë natyrore të zonës, duke kuptuar rëndësinë e ruajtjes me kujdes e përgjegjësi të çdo elementi të natyrës.

21 tetor 2025, Dita Botërore e Zvarranikëve

Në kuadër të “Ditës Botërore të Zvarranikëve”, specialistët e AdZM Shkodër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës “Prek Gjoni”. Përmes vizatimeve artistike dhe figurave të punuara me plastelinë, nxënësit u njohën më thellë me botën e zvarranikëve, duke mësuar për rolin, rëndësinë dhe bukurinë që ata sjellin në natyrë.

29 tetor 2025, orë mjedisore

Dita Kombëtare e Aktivizimit Mjedisor është një ditë e dedikuar angazhimit dhe veprimeve konkrete për mbrojtjen e natyrës. Në kuadër të kësaj dite, në bashkëpunim me Shoqatën Cukali dhe nxënësit e Shkollës 9-vjeçare “Gjergj Vat Martini”, AdZM Shkodër organizoi një aktivitet sensibilizues pastrimi në Vilun, pjesë e Peizazhit Ujor Tokësor të Mbrojtur “Lumi Buna–Velipojë”. Aktiviteti synoi të risë ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë mjedisore tek nxënësit.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



2 tetor 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare të fshatit Novosej, ku ata u njohën me pasurinë natyrore të Parkut Natyror “Korab-Koritnik” dhe rolin e tyre në ruajtjen e saj për brezat e ardhshëm. Aktiviteti përfshiu diskutime dhe aktivitete praktike mbi biodiversitetin dhe vlerat e parkut.

04 tetor 2025, Dita Botërore e Kafshëve

Në kuadër të Ditës Botërore të Kafshëve, specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Imer Mata”, Zapod, brenda Parkut Natyror Korab-Koritnik. Nxënësit u njohën me rëndësinë e mbrojtjes së kafshëve të egra dhe rolin që secili prej nesh ka në ruajtjen e biodiversitetit. Aktiviteti përfshiu vizatime, punime kreative dhe shpjegime praktike që synojnë të rrisin dashurinë dhe respektin për botën e gjallë.

06 tetor 2025, Dita Botërore e Habitave

Në kuadër të Ditës Botërore të Habitave, nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Imer Mata”, Zapod, morën pjesë në një orë mjedisore të zhvilluar nga specialistët e AdZM Kukës. Përmes vizatimeve, punimeve krijuese dhe shpjegimeve, ata u njohën me rëndësinë e ruajtjes së habitateve natyrore dhe rolin e secilit në mbrojtjen e biodiversitetit. Këto aktivitete synojnë të nxisin ndërgjegjësimin dhe dashurinë për natyrën tek brezat e rinj.



edukim mjedisor

biodiversitet

habitate

zona të mbrojtura

“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



15 tetor 2025, Dita Ndërkombëtare e Ecjes në Natyrë

Një ecje në natyrë u organizua nga specialistët e AdZM Kukës, përgjatë shtegut natyror “Liqeni i Kallabakut – Turaj”. Nxënës të ndryshëm patën mundësinë të eksploronin biodiversitetin e pasur, pamjet mahnitëse dhe ujërat e kristalta të liqenit. Ecja përfundoi në Monumentin e Natyrës “Mështekna e Shishtavecit”, një ekosistem i rrallë që demonstroi bukurinë dhe rëndësinë e ruajtjes së natyrës.

23 tetor 2025, orë mjedisore

Nxënësit e shkollës “Hamdi Pelivani” Orgjost morën pjesë në një orë mjedisore të organizuar nga specialistët e AdZM Kukës, mbi biodiversitetin, mbrojtjen e pyjeve dhe kujdesin ndaj pasurive natyrore që i rrethojnë. Përmes diskutimeve dhe shembujve praktikë u theksua se çdo veprim i vogël për mjedisin ka një ndikim të madh në të ardhmen tonë të përbashkët.



edukim mjedisor

biodiversitet

habitate

zona të mbrojtura

“EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



zogjtë shtegtarë

ekosistem

kafshë të egra



12 tetor 2025, shpendët shtegtarë

Në kuadër të Ditës Botërore të Shpendëve Shtegtarë, AdZM Dibër zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës së Bashkuar “Gjergj Kastrioti” në Baz. Nxënësit u njohën me llojet e shpendëve shtegtarë në vend, arsyet e shtegimit dhe rëndësinë e mbrojtjes së habitateve të tyre natyrore. Mbrojtja e habitateve të shpendëve është thelbësore, ky ishte mesazhi i cili u përcoll nga nxënësit.

15 tetor 2025, njohja me natyrën

AdZM Dibër zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 5-të të shkollës 9-vjeçare “Papa Gjon Pali II” në Ulëz, me temë “Njohja me natyrën”. Gjatë aktivitetit, fëmijët u ndanë në grupe dhe, duke përdorur materiale natyrore, krijuan vizatime dhe korniza artistike. Përmes kësaj pune kreative, ata u njohën më mirë me elementet e natyrës dhe mësuam të vlerësojnë bukurinë e saj.

24 tetor 2025, fauna në zonat e mbrojtura

Specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Gjergj Kastrioti” në Baz, me temë “fauna e zonave të mbrojtura”. Gjatë aktivitetit, nxënësit krijuan në mënyrë kreative figura kafshësh duke përdorur plastelinë, ngjyra, letra dhe karton, ndërsa mësuam për llojet e ndryshme të kafshëve, veçoritë e tyre dhe rëndësinë e tyre në ekosistem. Përmes kësaj ore, nxënësit kuptuan se natyra është pasuria e të gjithëve dhe duhet mbrojtur me kujdes.

“EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



3 tetor 2025, Dita Botërore e Kafshëve

Specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës IV të Shkollës 9-vjeçare “Nike Tom Prela”, Gorre. Nxënësit u njohën me faunën e egër që jeton në zonat e mbrojtura, rolin e saj në ekosisteme dhe rëndësinë e ruajtjes së kafshëve të egra. Në fund, fëmijët zgjidhën kuize dhe realizuan aktivitete ngjyrosjeje me tematikë faunën shqiptare, duke forcuar njohuritë e marra.

6 tetor 2025, Dita Botërore e Habitave

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës V të Shkollës 9-vjeçare “Kolec Mekshaj”. Nxënësit u njohën me konceptin e habitateve, rëndësinë e tyre për biodiversitetin dhe ndikimin e njeriut në dëmtimin apo ruajtjen e tyre. Aktiviteti u shoqërua me diskutime dhe punime praktike në klasë.

10 tetor 2025, Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë

Në këtë ditë, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës IV të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Ndoc Gjetja”. Nxënësit u njohën me shpendët shtegtarë, rrugët e migrimit dhe rëndësinë e mbrojtjes së habitateve të tyre. Aktiviteti u pasua nga loja edukative “Rrjeta e jetës”, e cila ndihmoi nxënësit të kuptojnë lidhjet mes gjallesave në natyrë.

13 tetor 2025, Dita Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore

Specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës VI të Shkollës 9-vjeçare “Fran Ivanaj”. Nxënësit morën njohuri mbi fatkeqësitë natyrore, rolin e biodiversitetit në zvogëlimin e rreziqeve dhe pasojat e dëmtimit të mjedisit. Pas prezantimit teorik, nxënësit punuan në mënyrë të pavarur në kuize, të cilat u diskutuan më pas në grup, duke nxitur mendimin kritik dhe ndërgjegjësimin mjedisor.



gov.al @akzmalbania @akzmalbania @a_k_z_m

Copyright AKZM All rights reserved

fauna

zona të mbrojtura

orë mjedisore





3 tetor 2025, Dita Botërore e Kafshëve

Specialistët zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare “Selman Ali Xaka”, Nuaj, në kuadër të Ditës Botërore të Kafshëve. Nxënësit u njohën me rëndësinë e kësaj dite ndërkombëtare dhe rolin jetik që kafshët kanë në ruajtjen e ekuilibrit ekologjik. Gjatë aktivitetit u theksua nevoja për mbrojtjen dhe respektimin e kafshëve përmes ruajtjes së habitateve natyrore dhe ndërgjegjësimit të komunitetit. Nxënësit morën gjithashtu njohuri mbi bimësinë dhe faunën karakteristike të Parkut Natyror Qafështamë, si një habitat i rëndësishëm për biodiversitetin e zonës.

6 tetor 2025, Dita Botërore e Habitave

Në kuadër të Ditës Botërore të Habitave, specialistët zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare “Myrteza Pengili”, Krujë. Nxënësit u njohën me konceptin e habitateve, rëndësinë e tyre për jetën e gjallesave, faktorët që i rrezikojnë dhe mënyrat e mbrojtjes së tyre. Aktiviteti vijoi me punë në grupe, ku nxënësit krijuan habitatet e tyre përmes aktiviteteve artistike dhe kreative, duke vendosur saktë gjallesat në mjedisin përkatës. Mesazhi kryesor i përcjellë ishte se habitatet janë shtëpia e gjallesave dhe mbrojtja e tyre do të thotë mbrojtje e jetës dhe e natyrës.

24 tetor 2025, Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën

Specialistët zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare “Arbëria”, Halil, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Veprimeve për Klimën. Nxënësit u njohën me ndryshimet klimatike, shkaqet e tyre, ngrohjen globale dhe efektin serë. Nëpërmjet një eksperimenti praktik, nxënësit kuptuan mënyrën se si çlirimi i dioksidit të karbonit ndikon në ngrohjen e planetit. Aktiviteti u shoqërua me punime artistike dhe mesazhe sensibilizuese, duke nxitur ndërgjegjësimin për veprim konkret në mbrojtje të klimës.



4 tetor 2025, Dita Botërore e Kafshëve

Në kuadër të Ditës Botërore të Kafshëve, u zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e klasave III dhe IV të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Bahri Nela”, Zall Bastar, pjesë e PKMD. Nxënësit u njohën me mënyrën e jetesës së kafshëve, habitatet e tyre, ushqimin dhe rolin që ato luajnë në ekosistem. Aktiviteti u shoqërua me punë krijuese, ku nxënësit realizuan maska me kafshën e tyre të preferuar dhe u njohën me monitorimin e faunës përmes kamerave kurth, duke rritur interesin dhe dashurinë e tyre për botën e egër.

6 tetor 2025, Dita Botërore e Habiteteve

Në këtë ditë, u zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e klasës VII të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Bahri Nela”, Zall Bastar, pjesë e PK “Mali i Dajtit”. Nxënësit u njohën me temën e këtij viti “Reagimi ndaj krizave urbane”, duke diskutuar mbi ndotjen, trafikun, mungesën e gjelbërimit dhe menaxhimin e mbetjeve. Përmes punës në grupe, nxënësit krijuan postera tematikë, duke kuptuar rëndësinë e planifikimit të qëndrueshëm urban dhe rolin e çdo qytetari në mbrojtjen e mjedisit.

11 tetor 2025, Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë

Në këtë ditë, u zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e klasës IV të Shkollës së Ciklit të Ulët “Brar”, pjesë e PK “Mali i Dajtit”. Nxënësit morën pjesë në diskutime, lojëra edukative dhe aktivitete krijuese mbi shpendët shtegtarë dhe habitatet e tyre. Gjatë aktivitetit, ata përgatitën ushqime të thjeshta për shpendët, duke mësuar rëndësinë e kujdesit për to, veçanërisht gjatë periudhës së dimrit.

“EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



13 tetor 2025, Dita Ndërkombëtare për Uljen e Fatkeqësive Natyrore

Një orë mjedisore u zhvillua me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Vilë Bashtovë”, Rogozhinë, pjesë e PK “Divjakë–Karavasta”. Nxënësit u njohën me shkaqet dhe pasojat e fatkeqësive natyrore, si dhe me rëndësinë e parandalimit dhe veprimit të hershëm. Aktiviteti u përmbyll me realizimin e një posteri simbolik me mesazhe sensibilizuese për mbrojtjen e mjedisit.w

24 tetor 2025, Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Veprimeve për Klimën, u zhvillua një aktivitet praktik me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Vilë Bashtovë”, Rogozhin. Nxënësit realizuan një aksion pastrimi në zonën e plazhit të Vilë-Bashtovës, duke dhënë një shembull konkret për përgjegjësinë qytetare dhe rëndësinë e veprimit individual për mbrojtjen e mjedisit dhe klimës.



natyrë
orë mjedisore

kafshët e egra
ditë botërore

“EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



04 tetor 2025, Dita Botërore e Kafshëve

Në kuadër të Ditës Botërore të Kafshëve, specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Shefqet Dosku”, Dorëz. Nxënësit u njohën me rëndësinë e kafshëve në ruajtjen e ekuilibrit ekologjik dhe me botën e egër të Parkut Kombëtar “Shebenik”, përmes pamjeve të kapura nga kamerat kurth. Aktiviteti përfshiu gjithashtu punime vizuale dhe krijuese, duke stimuluar njohuritë, kreativitetin dhe dashurinë për gjallesat e natyrës.

06 tetor 2025, Dita Botërore e Habitaveve

Specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Isak Alla”, Zgost. Gjatë aktivitetit u prezantua materiali mbi habitatet dhe rëndësia e tyre brenda Parkut Kombëtar “Shebenik”. Nxënësit u përfshinë në një aktivitet praktik në grupe, duke plotësuar pyetësorë mbi habitatet dhe duke kuptuar se si mund të kontribuojnë në ruajtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit.

10 tetor 2025, Vizitë në Parkun Kombëtar “Shebenik”

Qendra e Vizitorëve e Parkut Kombëtar “Shebenik” shërbeu si një qendër edukimi mjedisor për nxënësit. Gjatë vizitës, nxënësit e shkollës jo-publike “Vatra e Dijes”, Tiranë, eksploruan natyrën e zonës dhe shijuan bukuri të Fushë-Studen, duke marrë një përvojë të drejtpërdrejtë mbi rëndësinë e ruajtjes së ekosistemeve dhe biodiversitetit.

24 tetor 2025, Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën

Specialistët e AdZM Elbasan, së bashku me punonjësit e PONT, organizuan një aksion pastrimi me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare “Librazhd Katund”. Ky aktivitet synoi krijimin e një ambienti të pastër dhe përcolli mesazhin se mbrojtja e mjedisit duhet të mbetet detyrë kryesore e brezave të rinj dhe komunitetit, duke inkurajuar veprime konkrete për një mjedis të shëndetshëm.

ditë botërore

fauna

edukim mjedisor

zona të mbrojtura

“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



4 tetor 2025, aktivitet edukues në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta

Nxënësit e shkollës “Mihal Egonomi”, Durrës morën informacion nga specialistët e AdZM Fier mbi vlerat natyrore dhe biodiversitetin e parkut. Më pas, aktiviteti vijoi me një ecje përgjatë shtigjeve, ku nxënësit shijuan bukuritë e natyrës dhe u njohën më afër me habitatet e ndryshme të lagunës.

6 tetor 2025, Dita Botërore e Habitave

Specialistët e AdZM Fier zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Mizë”, Divjakë . Nxënësit u njohën nga afër me habitatet kryesore të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta dhe rëndësinë e mbrojtjes së tyre, duke marrë pjesë në aktivitete praktike dhe interaktive për të forcuar ndërgjegjësimin mjedisor.

10 tetor 2025, njohja e lagunës dhe shpendëve ujorë

Nxënësit e shkollës “Flatrat e Dijes” morën pjesë në një aktivitet ndërgjegjëses dhe edukues në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Ata vizituan Godullën dhe Kanalin e Vahut, ku vëzhguan shpendë të ndryshëm ujorë. Specialistët ofruan shpjegime mbi rëndësinë ekologjike të lagunës, ruajtjen e biodiversitetit dhe rolin e secilit për mbrojtjen e natyrës.

11 tetor 2025, Dita Ndërkombëtare e Ecjes në Natyrë

AdZM Fier zhvilloi një ecje në Shtegun e Pelikanit, së bashku me nxënës dhe dashamirës të natyrës, duke promovuar aktivitetin fizik dhe ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e mbrojtjes së natyrës.

“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



14-16 tetor 2025, Kamp edukues për unazimin e shpendëve

Nxënësit e shkollave 9-vjeçare “Germenj”, “Mihal Nako” Fier-Seman dhe “Mizë”) morën pjesë në një eksperiencë edukues në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, në kuadër të kampit të unazimit të shpendëve të organizuar nga Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë (AOS) në bashkëpunim me AdZM Fier. Nxënësit mësuan mbi llojet e shpendëve, rrugët migratore, procesin e unazimit dhe rëndësinë e ruajtjes së faunës dhe habitatit.

20 tetor 2025, Maratona “Kalorësja e Arnisë”

Nxënës nga shkolla dhe pjesëmarrës nga zona të ndryshme morën pjesë në një maratonë në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, e organizuar nga Ecotour Albania, duke kombinuar aktivitetin fizik me njohjen e natyrës dhe edukimin mjedisor.

24 tetor 2025, Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën

Specialistët e AdZM Fier zhvilluan një aktivitet edukues me studentë francezë dhe nxënës të shkollës 9-vjeçare “Hasan Koçi” nga Durrësi ku u njohën me vlerat natyrore, biodiversitetin, ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe masat për ruajtjen e ekosistemeve. Aktiviteti përfshiu birdwatching dhe krijimin e herbariumit nga bimësia vendase e mbledhur në park.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



edukim mjedisor

biodiversitet

fauna

zona të mbrojtura

4 tetor 2025, Dita Botërore e Kafshëve

Specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Raif Kolami” në Tren, ku diskutuan rëndësinë e mbrojtjes së kafshëve dhe biodiversitetit të Rajonit të Korçës, pjesë e koridorit ekologjik të Alpeve Dinarike. Nxënësit u njohën me habitatet alpine, burimet ujore dhe speciet e mbrojtura dhe morën pjesë në diskutime dhe aktivitete praktike për të kuptuar se si veprimet e tyre mund të ndikojnë në ruajtjen e mjedisit.

6 tetor 2025, Dita Botërore e Kafshëve

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë mjedisore brenda Parkut Natyror Korab-Koritnik me nxënësit e shkollës “Imer Mata” në Zapod. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me habitatet kryesore të parkut dhe rëndësinë e tyre për ruajtjen e biodiversitetit. Përmes vizatimeve, punimeve krijuese dhe diskutimeve, ata kuptuan rolin e secilit në ruajtjen e natyrës dhe mjedisit për brezat që vijnë.

7 tetor 2025, Dita e Mbrojtjes së Dinarideve

Dinaridet përbëjnë një nga rajonet më të pasura natyrore në Ballkan, me habitate alpine, pyje të dendura dhe biodiversitet të larmishëm të florës dhe faunës. Specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë edukimi mjedisor me nxënësit e klasave 7 dhe 8 të shkollës 9-vjeçare “Raif Kolami” në Tren, ku bashkëbiseduan për rëndësinë e mbrojtjes dhe promovimit të pasurisë natyrore të rajonit, pjesë e rrjetit të gjelbër ballkanik.

7 tetor 2025, Flora dhe Fauna

Specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë edukimi mjedisor me nxënësit e shkollës “Muharrem Çollaku”, ku u njohën me rëndësinë e florës dhe faunës në rajonin e Korçës. Nxënësit bashkëbiseduan për dashurinë dhe respektin që duhet të kemi ndaj mjedisit dhe rolin që secili ka në ruajtjen e natyrës.



“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



10 tetor 2025, shpendët shtegëtarë

Në kuadër të Ditës Botërore të Shpendëve Shtegëtarë, specialistët e AdZM Korçë realizuan një orë edukimi mjedisor me nxënësit e gjimnazit “Petro Nini Luarasi”, Kolonjë. Nxënësit u njohën me shpendët shtegëtues të zonës dhe florën dhe faunën përreth, si dhe u sensibilizuan për rëndësinë e ruajtjes së tyre dhe shmangies së gjuetisë.

13 tetor 2025 , Ulja e Fatkeqësive Natyrore

Specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e Kolegjit “Preca College”, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për uljen e fatkeqësive natyrore dhe masat që mund të ndërmerren për parandalimin e tyre.

15 tetor 2025 , Ulja e Fatkeqësive Natyrore

Nxënësit e shkollës “Muharrem Çollaku” morën pjesë në një ecje përgjatë Gadishullit të Linit, organizuar nga specialistët e AdZM Korçë.. Gjatë kësaj ecje, ata patën mundësinë të njiheshin më afër me pasuritë natyrore, florën dhe faunën e zonës, si dhe të kuptonin rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe e zonave të mbrojtura. Ky aktivitet synoi të forconte lidhjen e nxënësve me natyrën dhe të nxisë dashurinë dhe respektin për ambientin që na rrethon.

24 tetor 2025 , Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën

Specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Papa Kristo Negovani” dhe nxënës të shkollës “2 Dëshmorët” Pustec, ku u ndanë mesazhe sensibilizuese për efikasitetin energjitik, ruajtjen e klimës dhe mbrojtjen e mjedisit. Nxënësit morën pjesë në aktivitete praktike për krijimin e sloganeve dhe banner-ave sensibilizuese.



edukim mjedisor

biodiversitet

fauna

zona të mbrojtura



8 tetor 2025, aksion pastrimi

Specialistët e AdZM Berat, së bashku me nxënës të shkollës 9-vjeçare “Myslym Bakeri”, ndërmorën një aksion pastrimi përgjatë shtratit të lumit Osum. Gjatë këtij aktiviteti, nxënësit u përfshinë aktivisht në pastrimin e mbetjeve, duke kuptuar rëndësinë që lumenjtë kanë për ekosistemet, biodiversitetin dhe jetën e komuniteteve përreth. Përmes këtij veprimi praktik u përcoll një mesazh i fortë mbi domosdoshmërinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së lumenjve si pasuri natyrore e përbashkët.

22 tetor 2025, mbjellje fidanësh

Në një tjetër aktivitet mjedisor të zhvilluar gjatë muajit tetor, specialistët e AdZM Berat, në bashkëpunim me nxënës të shkollës 9-vjeçare “Roshnik”, realizuan mbjelljen e fidanëve pyjorë. Ky aktivitet synoi rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e pemëve në ruajtjen e ekuilibrit natyror, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e mjedisit.

ditë botërore
biodiversitet

zona të mbrojtura
ekosistem



4 tetor 2025, Dita Botërore e Kafshëve

Fëmijët e kopshtit “Cicërimat” në Gjirokastrë morën pjesë në një orë mjedisore me specialistët e ADZM Gjirokastrë. Gjatë aktivitetit, fëmijët u njohën me kafshët që jetojnë në zonat e mbrojtura dhe mësuam për përdorimin e kamerës kurth dhe dylbit në monitorimin e kafshëve. Aktiviteti synoi të rrisë ndërgjegjësimin e fëmijëve për botën e egër dhe rëndësinë e mbrojtjes së saj.

23 tetor 2025, zona të mbrojtura

Nxënësit e shkollës “Xhuzepe Gras” zhvilluan një orë mjedisore me specialistët e ADZM Gjirokastrë. Gjatë kësaj ore, nxënësit u njohën me konceptin dhe rëndësinë e zonave të mbrojtura, si dhe me mënyrat se si mund të kontribuojnë në ruajtjen e tyre. Aktiviteti synoi të ndërgjegjësojë brezat e rinj për ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit lokal.



15 tetor 2025, Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë

Specialistët e ADZM Vlorë, në bashkëpunim me specialistët e Mjedisit të Bashkisë Vlorë dhe organizatën PPNEA, zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Kafil Malaj” në Bishan. Nxënësit morën pjesë në diskutime, prezantime dhe aktivitete praktike mbi rëndësinë e mbrojtjes së shpendëve dhe habitateteve të tyre, duke u njohur me rolin që secili ka në ruajtjen e biodiversitetit.

28 tetor 2025, orë mjedisore

Pranë shkollës “Kafil Malaj” Bishan, ADZM Vlorë organizoi një orë mjedisore në bashkëpunim me specialistët e Mjedisit të Bashkisë Vlorë dhe PPNEA. Nxënësit morën pjesë në aktivitete informuese dhe prezantime, ku u theksua rëndësia e ruajtjes së shpendëve dhe habitateteve të tyre, si dhe përgjegjësia e secilit për mbrojtjen e biodiversitetit lokal.

